

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Mbështetje për programin (Projektim, mbikqyrje, kolaudim) PO”:  
Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve, i ndarë në 4 Lote.**

Loti 1: “Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve per “Ndertimi i infrastruktures se modeleve te integruara ne zona me potencial zhvillimi, rigjenerim urban i hapësirave publike, promenada, bulevarde, sheshe, nderhyrje ne zona turistike, etj.”

Loti 2: “Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve për “Ngritja e infrastruktures arsimore te Kolegjit te Europes”, etj.”

Loti 3: “Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve për “Mbeshtetje per infrastruktures akomoduese te KQZ, investime pilot për transformimin e infrastrukturës se sherbimeve dhe rritjes se standartit te jetes ne komunitet, transformimi i infrastrukturës akomoduese në kampuset rajonale të arsimit profesional, Krijimi i parqeve tematike ne funksion te evokimit te vlerave kulturore, etj.”

Loti 4: “Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve për “Ndërhyrje e Integruar për fuqizimin e potencialit turistik në zonat natyrore, nderhyrje per rehabilitim dhe transformim mjedisor, peisazhit urban dhe natyror, rderhyrje per rigjenerimin urban, mbrojtje detare, trajtim ujrash ne zonen bregdetare, Përmirësimi i Infrastrukturës së Parkimit Faza II, etj.”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV)- 71247000-1**

**VLERA E FONDIT LIMIT**1. Fondi limit i Marrëveshjes në total është në vlerën: 68,865,685 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 684,821.84 Euro. Financimi i këtij objekti është parashikuar në programet buxhetore për periudhën 2024-2026. Kodi Output: 22AB801.

Loti 1: “Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve per “Ndertimi i infrastruktures se modeleve te integruara ne zona me potencial zhvillimi, rigjenerim urban i hapësirave publike, premonada, bulevarde, sheshe, nderhyrje ne zona turistike, etj”, me fond limit të marrëveshjes kuadër 19,256,792 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 191,495.54 Euro.

- Loti 2: “Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve për “Ngritja e infrastruktures arsimore te Kolegjit te Europes”, me fond limit të marrëveshjes kuadër 14,481,250 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 144,006.06 Euro.

- Loti 3: “Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve për “Mbeshtetje per infrastruktures akomoduese te KQZ, investime pilot për transformimin e infrastrukturës se sherbimeve dhe rritjes se standartit te jetes ne komunitet , transformimi i infrastrukturës akomoduese në kampuset rajonale të arsimit profesional ,Krijimi i parqeve tematike ne funksion te evokimit te vlerave kulturore, etj.”, me fond limit të marrëveshjes kuadër 18,899,549 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 187,943.00 Euro.

- Loti 4: “Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve për “Ndërhyrje e Integruar për fuqizimin e potencialit turistik në zonat natyrore, nderhyrje per rehabilitim dhe transformim mjedisor, peisazhit urban dhe natyror, rderhyrje per rigjenerimin urban, mbrojtje detare, trajtim ujrash ne zonen bregdetare, Përmirësimi i Infrastrukturës së Parkimit Faza II, etj.”, me fond limit të marrëveshjes kuadër 16,228,094 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 161,377.22 Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor **FSHZH** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Loti 1: “Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve per “Ndertimi i infrastruktures se modeleve te integruara ne zona me potencial zhvillimi, rigjenerim urban i hapësirave publike, premonada, bulevarde, sheshe, nderhyrje ne zona turistike, etj.”**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas kriterëve të përgjithsme sipas shtojcës 9

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontrates në procedurën e prokurimit. Loti 1

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: *Lloji i procedure eshte ”Hapur”, percaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa ”b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998*

"Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, veçim nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në mbështetje të nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

### 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 30% e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të

shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizuara.

- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.”

Kriteri është miratuar me qëllim vërtetimin për eksperiencat e ngjashme të operatorit/ëve në fushën objekt prokurimi me qëllim realizimin e objektit të kontratës. Përvoja e operatorit është element shumë i nevojshëm për autoritetin, për të vërtetuar qendrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Në kuptim të nenit 41 të VKM-se vlerësohet vlera e kërkuar në masën 40 % e cila është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës rrjedhimisht nuk sjellë kufizim të pjesëmarrjes në garë të operatorëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për kryerjen e shërbimit objekt kontrate të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e projektimit duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme

Për mbikqyrjen e punimeve të përgjithshme të ndërtimit Operatori Ekonomik duhet të ketë licencat e mëposhtme:

- N.P – 1. Punime gjurmimi në tokë.
- N.P – 2. Ndërtime civile e industriale.
- N.P – 3. Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
- N.P – 4. Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- N.P – 5. Punime nëntoksore, ura e vepra arti.
- N.P – 7. Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje
- N.P – 11. Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- N.P – 12. Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për mbikqyrjen e punimeve speciale të ndërtimit Operatori Ekonomik duhet të ketë licencat e mëposhtme:

- N.S – 1. Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S – 2. Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavaxantieri, mirëmbajtja e tyre.
- N.S – 4. Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik, xhami dhe rifiniture të natyres teknike ndërtuese.
- N.S – 5. Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.
- N.S – 6. Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.

- N.S – 7. Barrierra dhe mbrojtje rrugore.
- N S – 9. Punime strukturore speciale.
- N S – 12. Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- N S – 14. Impiante të brëndshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV
- N.S – 18. Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjië, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale profesionale te individeve dhe subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ne fushen e studimit te projektimit te ndertimit dhe mbikeqyrje e kolaudikimit te punimeve miratura me VKM- ne, Nr.759, date 12.11.2014 i ndryshyar. Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Llogaritja të bëhet duke u mbështetur në VKM nr. 354, datë 23/05/2016 (Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Teritori, Projektim, Mbikeqyrje dhe Kolaudim),

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit te Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente . Licencat janë të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës për mbikeqyrjen e objekteve. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

*Meqenese kemi te bejme me mbikeqyrjen e punimeve ne zbatim argumentojme se Kategorite e mesiperme jane percaktuar ne perputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventivin e punimeve të zbatimit.*

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor per ndjekjen e supervizionit minimalisht. Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatoreve Ekonomike duhet te paraqesin nje liste te stafit kryesor te meposhtem, te cilet duhet te kene nje marredhenie kontraktore me operatorin apo partneret ne rastin e nje bashkimi operatoresh. Per çdo pozicion, operatoret jane te lire te propozojne me shume se nje kandidat, me qellim permbushjen e kriterëve te kerkuara. Pozicionet e stafit kryesor te kerkuar jane si më poshtë:

- Team Leader 1 (një)
- Arkitekt 1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)

- Inxhiner Elektrik 1 (një)
- Inxhiner Mekanik 1 (një)
- Inxhiner Hidroteknik 1 (një)
- Inxhiner Mjedisi 1 (një)
- Kontrollor Cilesie 1 (një)
- Kontrollor i volumeve
- te punes (Quantity Surveyour) 1 (një)
- Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE) 1 (një)

Gjithashtu Operatori Ekonomik duhet të propozojë Staf Inxhinierik “Ing. Resident” që do të ndjekë punimet çdo ditë në terren, operatori ekonomik do duhet që në cdo kantier të ketë një Ing. Resident.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti, për secilin prej inxhinierëve të lartpërmendur Operoret Ekonomike duhet të paraqesin;

- kualifikimet arsimore (diplomat),
- kualifikimet profesionale (licencat profesionale),
- CV.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9

***Në këtë rast, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.***

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Per stafin e angazhuar - Marreveshje/kontrate shërbimi apo deklarate nga vete eksperti me nje akt noterial ku te shprehe angazhimin me operatorin fitues kundrejt zbatimit te shërbimit te mbikqyrjes per kete object prokurimi (perskrim per funksionin/rolin qe do te kryeje dhe detyrat perkatese)

***Shenim: Për efekt të vlerësimit me pike sipas pikes 4.4 ne Njoftimin e Kontrates, operatorët të ngarkojnë dokumentacionin: CV, certifikata/diploma/kualifikime profesionale si dhe per Drejtues i Ekipit licencen profesionale për mbikëqyrje.***

Gjithashtu per stafin e propozuar te paraqitet informacioni i kerkuar mbi ekperiencon specifike, sipas percaqtimeve te Aneksit nr 1 pjese e ketij DT:

2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të disponojë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të siguar për çdo muaj për periudhën 3 (tre) mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për të vërtetuar këtë kusht, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën për periudhën 3 (tre) mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit, i cili duhet të përputhet me listë pagesat e punonjësve për këtë periudhë.

Shtojcës nr. 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.”



**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur duke u bazuar në shërbimet e kerkuara sipas Termave të referencës.

-Përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e- tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

-Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

*Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, do të paraqiten përpara se AK të japë kontratën.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

- Argumentimi: Referuar në nenin 41 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.” Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me numrin e objekteve të kontratës së zbatimit dhe vendndodhjen e tyre. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës dhe i bazuar në ligj, me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe mbikeqyrjen e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Personeli teknik i inxhinierëve, kapacitetet dhe aftësitë organizative janë të domosdoshëm gjatë mbikeqyrjes së objekteve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për kolaudimin sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe brenda kushteve të kontratës. Në lidhje me inxhinierin e mjedisit operatori/ëti ekonomik/ë gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ku në nenin 1 parashikohet shprehimisht: “Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit” dhe VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo operator ekonomik, person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Roli i inxhinierave është përcaktuar dhe në Termat e Referencës.

**-Loti 2: “Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve për “Ngritja e infrastruktures arsimore te Kolegjit te Europes”, etj.”**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithsme sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së parashikuar te kontrates në procedurën e prokurimit Loti 2

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 42 dhe 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: *Percaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 42 dhe 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.*

*Lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e



përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilanci e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilancave është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

*Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 30% e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizuara.
- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik."

Kriteri është miratuar me qëllim vërtetimin për eksperiencat e ngjashme të operatorit/ëve në fushën objekt prokurimi me qëllim realizimin e objektit të kontratës.. Përvoja e operatorit është element shumë i nevojshëm për autoritetin, për të vërtetuar qendrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Në kuptim të nenit 41 të VKM-se vlerësohet

vlera e kërkuar në masen 30 % e cila është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës rrjedhimisht nuk sjellë kufizim të pjesëmarrjes në garë të operatorëve. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për kryerjen e shërbimit objekt kontrate të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016*”. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e projektimit duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Për mbikqyrjen e punimeve të përgjithshme të ndërtimit Operatori Ekonomik duhet të ketë licencat e mëposhtme:

- N.P – 1. Punime gërmimi në tokë.
- N.P – 2. Ndërtime civile e industriale.
- N.P – 3. Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
- N.P – 7. Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje
- N.P – 11. Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- N.P – 12. Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për mbikqyrjen e punimeve speciale të ndërtimit Operatori Ekonomik duhet të ketë licencat e mëposhtme:

- N S – 1. Punime për prishjen e ndërtimeve
- N S – 2. Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
- N S – 4. Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik, xhami dhe rifiniture të natyres teknike ndërtuese.
- N S – 9. Punime strukturore speciale.
- N S – 12. Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- N S – 14. Impiante të brëndshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV
- N.S – 18 Punime topogjeodezike

Llogaritja të bëhet duke u mbështetur në VKM nr. 354, datë 23/05/2016 (Per miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim),

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrjnë

*veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”*

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente . Licencat janë të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës për mbikqyrjen e objekteve. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.*

*Meqenese kemi te bejme me mbikqyrjen e punimeve ne zbatim argumentojme se Kategorite e mesiperme jane percaktuar ne perputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventivin e punimeve të zbatimit.*

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor për ndjekjen e supervizionit minimalisht. Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatoreve Ekonomike duhet të paraqesin një listë të stafit kryesor të mëposhtem, të cilët duhet të kenë një marrëdhënie kontraktore me operatorin apo partneret në rastin e një bashkimi operatorësh. Për çdo pozicion, operatorët janë të lirë të propozojnë me shumë se një kandidat, me qëllim përmbushjen e kriterëve të kërkuara. Pozicionet e stafit kryesor të kërkuar janë si më poshtë:

- Team Leader *1 (një)*
- Arkitekt *1 (një)*
- Inxhinier Ndërtimi *1 (një)*
- Inxhinier Gjeodet *1 (një)*
- Inxhinier Elektrik *1 (një)*
- Inxhinier Mekanik *1 (një)*
- Inxhinier Hidroteknik *1 (një)*
- Inxhinier Mjedisi *1 (një)*
- Kontrollor Cilesie *1 (një)*
- Kontrollor i volumeve  
te punes (Quantity Surveyour) *1 (një)*
- Inspektor të sigurimit dhe  
Shëndetit në punë (HSE) *1 (një)*

Gjithashtu Operatori Ekonomik duhet të propozojë Staf Inxhinierik “Ing. Resident” që do të ndjekë punimet çdo ditë në terren, operatori ekonomik do duhet që në çdo kantier të ketë një Ing. Resident.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti, për secilin prej inxhinierëve të lartpërmendur Operoret Ekonomike duhet të paraqesin;

- kualifikimet arsimore (diplomat),
- kualifikimet profesionale (licencat profesionale),
- CV.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9

***Në këtë rast, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.***

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Per stafin e angazhuar - Marreveshje/kontrate shërbimi apo deklarate nga vete eksperti me nje akt noterial ku te shprehe angazhimin me operatorin fitues kundrejt zbatimit te shërbimit te mbikqyrjes per kete object prokurimi (pershkrim per funksionin/rolin qe do te kryeje dhe detyrat perkatese)

***Shenim: Për efekt të vlerësimit me pike sipas pikes 4.4 ne Njoftimin e Kontrates, operatorët të ngarkojnë*** dokumentacionin: CV, certifikata/diploma/kualifikime profesionale si dhe per Team Leader licencen profesionale për mbikëqyrje.

Gjithashtu per stafin e propozuar te paraqitet informacioni i kerkuar mbi ekperiencon specifike, sipas percaktimeve te Aneksit nr 1 pjese e ketij DT:

2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të disponojë jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës të siguruar për çdo muaj për periudhen 3 (tre) mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për të vërtetuar këtë kusht, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën për periudhen 3 (tre) mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit, i cili duhet të përputhet me listë pagesat e punonjësve për këtë periudhë.

***Argumentimi:*** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

*Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur duke u bazuar ne shërbimet e kerkuara sipas Termave te references,*

-Përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e- tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

-Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

*Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,do te paraqiten perpara se AK te jape kontraten.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

**Argumentimi:** Referuar në nenin 41 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik." Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me numrin e objekteve të kontratës së zbatimit dhe vendndodhjen e tyre. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës dhe i bazuar në ligj, me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe mbikeqyrjen e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Personeli teknik i inxhinierëve, kapacitetet dhe aftësitë organizative janë të domosdoshëm gjatë mbikeqyrjes së objekteve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për kolaudimin sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe brenda kushteve të kontratës. Në lidhje me inxhinierin e mjedisit operatori/ët ekonomik/ë gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", ku në nenin I parashikohet shprehimisht: "Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit" dhe VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo operator ekonomik, person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Roli i inxhinierave është përcaktuar dhe në Termat e Referencës.

**Loti 3: "Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve për "Mbeshtetje për infrastrukture akomoduese të KQZ, investime pilot për transformimin e infrastrukturës së shërbimeve dhe rritjes së standartit të jetesës në komunitet, transformimi i infrastrukturës akomoduese në kampuset rajonale të arsimit profesional, Krijimi i parqeve tematike në funksion të evokimit të vlerave kulturore, etj.."**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e Lotit (vlera e fondit limit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 42 dhe 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 42 dhe 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar,

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në mbështetje të nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare 2022, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilanci e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilancit është bërë duke iu referuar legjislativës të fushës, konkretisht, *ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.*

*Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën*



prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 30% e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- c) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizuara.
- d) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik."

Kriteri është miratuar me qëllim vërtetimin për eksperiencat e ngjashme të operatorit/ëve në fushën objekt prokurimi me qëllim realizimin e objektit të kontratës. Përvoja e operatorit është element shumë i nevojshëm për autoritetin, për të vërtetuar qendrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Në kuptim të nenit 41 të VKM-se vlerësohet vlera e kërkuar në masën 30 % e cila është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës rrjedhimisht nuk sjellë kufizim të pjesëmarrjes në garë të operatorëve. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për kryerjen e shërbimit objekt kontrate të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016"*. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e projektimit duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Për mbikqyrjen e punimeve të përgjithshme të ndërtimit Operatori Ekonomik duhet të ketë licencat e mëposhtme:

- N.P – 1. Punime gërmimi në tokë.
- N.P – 2. Ndërtime civile e industriale.
- N.P – 3. Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
- N.P – 4. Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- N.P – 5. Punime nëntoksore, ura e vepra arti.
- N.P – 7. Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje

- N.P – 11. Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- N.P – 12. Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për mbikqyrjen e punimeve speciale të ndërtimit Operatori Ekonomik duhet të ketë licencat e mëposhtme:

- N.S – 1. Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S – 2. Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
- N.S – 4. Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik, xhami dhe rifiniture të natyres teknike ndërtuese.
- N.S – 5. Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.
- N.S – 6. Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
- N.S – 7. Barrierra dhe mbrojtje rrugore.
- N.S – 9. Punime strukturore speciale.
- N.S – 12. Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- N.S – 14. Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV
- N.S – 18. Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale profesionale te individëve dhe subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ne fushen e studimit te projektimit te ndertimit dhe mbikeqyrje e kolaudikimit te punimeve miratura me VKM- ne, Nr.759, date 12.11.2014 i ndryshuar. Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Llogaritja të bëhet duke u mbështetur në VKM nr. 354, datë 23/05/2016 (Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Teritori, Projektim, Mbikeqyrje dhe Kolaudim),

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente . Licencat janë të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës për mbikeqyrjen e objekteve. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Meqenese kemi te bejme me mbikeqyrjen e punimeve ne zbatim argumentojme se Kategorite e mesiperme jane percaktuar ne perputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventivin e punimeve të zbatimit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor per ndjekjen e supervizionit minimalisht. Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatoreve Ekonomike duhet te paraqesin nje liste te stafit kryesor te meposhtem, te cilet duhet te kene nje marredhenie kontraktore me operatorin apo partneret ne rastin e nje bashkimi operatoresh. Per çdo pozicion, operatoret jane te lire te propozojne me shume se nje kandidat, me qellim permbushjen e kriterëve te kerkuara. Pozicionet e stafit kryesor te kerkuar jane si më poshtë:

- Team Leader 1 (një)
- Arkitekt 1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Mjedisi 1 (një)
- Kontrollor Cilesie 1 (një)
- Kontrollor i volumeve  
te punes (Quantity Surveyour) 1 (një)
- Inspektor të sigurimit dhe  
Shëndetit në punë (HSE) 1 (një)

Gjithashtu Operatori Ekonomik duhet të propozojë Staf Inxhinierik “Ing. Resident” që do të ndjekë punimet çdo ditë në terren, operatori ekonomik do duhet që në cdo kantier të ketë një Ing. Resident. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti, për secilin prej inxhinierëve të lartpërmendur Operoret Ekonomike duhet të paraqesin;

- kualifikimet arsimore (diplomat),
- kualifikimet profesionale (licencat profesionale),
- CV.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9

***Në këtë rast, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.***

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese  
Per stafin e angazhuar - Marreveshje/kontrate sherbimi apo deklarate nga vete eksperti me nje akt noterial ku te shprehe angazhimin me operatorin fitues kundrejt zbatimit te sherbimit te mbikqyrjes per kete object procurimi (pershkrim per funksionin/rolin qe do te kryeje dhe detyrat perkatese)

***Shenim: Për efekt të vlerësimit me pike sipas pikes 4.4 ne Njoftimin e Kontrates, operatorët të ngarkojnë dokumentacionin: CV, certifikata/diploma/kualifikime profesionale si dhe per Drejtues i Ekipit licencen profesionale për mbikëqyrje.***

Gjithashtu për stafin e propozuar të paraqitet informacioni i kërkuar mbi ekperiencën specifike, sipas përcaktimeve të Aneksit nr 1 pjesë e këtij DT:

2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të disponojë jo më pak se 14 (katërbëdhjetë) punonjës të siguruar për çdo muaj për periudhën 3 (tre) mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për të vërtetuar këtë kusht, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën për periudhën 3 (tre) mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, i cili duhet të përputhet me listë pagesat e punonjësve për këtë periudhë..

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur duke u bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të referencës,

-Përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e- tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

-Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

*Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, do të paraqiten përpara se AK të japë kontratën.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

**Argumentimi:** Referuar në nenin 41 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.” Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me numrin e objekteve të kontratës së zbatimit dhe vendndodhjen e tyre. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës dhe i bazuar në ligj, me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe mbikeqyrjen e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Personeli teknik i inxhinierëve, kapacitetet dhe aftësitë organizative janë të domosdoshëm gjatë mbikeqyrjes së objekteve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për kolaudimin sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe brenda kushteve të kontratës. Në lidhje me inxhinierin e mjedisit operatori/ët ekonomik/ë gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon

Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ku në nenin 1 parashikohet shprehimisht: “Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit” dhe VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo operator ekonomik, person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Roli i inxhinierave është përcaktuar dhe në Termat e Referencës.

**-Loti 4: “Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve për “Ndërhyrje e Integruar për fuqizimin e potencialit turistik në zonat natyrore, ndërhyrje për rehabilitim dhe transformim mjedisor, peisazhit urban dhe natyror, ndërhyrje për rigjenerimin urban, mbrojtje detare, trajtim ujrash në zonën bregdetare , Përmirësimi i Infrastrukturës së Parkimit Faza II, etj.”**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e Lotit (vlera e fondit limit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 42 dhe 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: *Përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 42 dhe 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në mbështetje të nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të*

prokurimit publik” ku percaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 30% e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- e) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizuara.



- f) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.”

Kriteri është miratuar me qëllim vërtetimin për eksperiencat e ngjashme të operatorit/ëve në fushën objekt prokurimi me qëllim realizimin e objektit të kontratës. Përvoja e operatorit është element shumë i nevojshëm për autoritetin, për të vërtetuar qendrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Në kuptim të nenit 41 të VKM-se vlerësohet vlera e kërkuar në masën 20 % e cila është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës rrjedhimisht nuk sjellë kufizim të pjesëmarrjes në garë të operatorëve. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për kryerjen e shërbimit objekt kontrate të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e projektimit duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme: Për mbikqyrjen e punimeve të përgjithshme të ndërtimit Operatori Ekonomik duhet të ketë licencat e mëposhtme:

- N.P – 1. Punime gjurmimi në tokë.
- N.P – 2. Ndërtime civile e industriale.
- N.P – 3. Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
- N.P – 4. Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- N.P – 5. Punime nëntoksore, ura e vepra arti.
- N.P – 7. Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje
- N.P – 11. Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- N.P – 12. Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për mbikqyrjen e punimeve speciale të ndërtimit Operatori Ekonomik duhet të ketë licencat e mëposhtme:

- N.S – 1. Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S – 2. Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavaxteri, mirëmbajtja e tyre.
- N.S – 4. Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik, xhami dhe rifiniture të natyres teknike ndërtuese.
- N.S – 5. Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.

- N.S – 6. Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
- N.S – 7. Barrierra dhe mbrojtje rrugore.
- N S – 9. Punime strukturore speciale.
- N S – 12. Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- N S – 14. Impiante të brëndshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV
- N.S – 18. Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale profesionale te individeve dhe subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ne fushen e studimit te projektimit te ndertimit dhe mbikeqyrje e kolaudikimit te punimeve miratura me VKM- ne, Nr.759, date 12.11.2014 i ndryshyar. Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Llogaritja të bëhet duke u mbështetur në VKM nr. 354, datë 23/05/2016 (Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Teritori, Projektim, Mbikeqyrje dhe Kolaudim),

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente . Licencat janë të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës për mbikeqyrjen e objekteve. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Meqenese kemi te bejme me mbikeqyrjen e punimeve ne zbatim argumentojme se Kategorite e mesiperme jane percaktuar ne perputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventivin e punimeve të zbatimit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor për ndjekjen e supervizionit minimalisht, Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatoreve Ekonomike duhet të paraqesin një listë të stafit kryesor të mëposhtem, të cilët duhet të kenë një marrëdhënie kontraktore me operatorin apo partneret në rastin e një bashkimi operatorësh. Për çdo pozicion, operatorët janë të lire të propozojnë me shumë se një kandidat, me qëllim përmbushjen e kriterëve të kërkuara. Pozicionet e stafit kryesor të kërkuar janë si më poshtë:

- Team Leader 1 (një)
- Arkitekt 1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

- Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Mjedisi 1 (një)
- Kontrollor Cilesie 1 (një)
- Kontrollor i volumeve  
te punes (Quantity Surveyour) 1 (një)
- Inspektor të sigurimit dhe  
Shëndetit në punë (HSE) 1 (një)

Gjithashtu Operatori Ekonomik duhet të propozojë Staf Inxhinierik “Ing. Resident” që do të ndjekë punimet çdo ditë në terren, operatori ekonomik do duhet që në cdo kantier të ketë një Ing. Resident.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti, për secilin prej inxhinierëve të lartpërmendur Operoret Ekonomike duhet të paraqesin;

- kualifikimet arsimore (diplomat),
- kualifikimet profesionale (licencat profesionale),
- CV

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9

***Në këtë rast, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.***

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Per stafin e angazhuar - Marreveshje/kontrate shërbimi apo deklarate nga vete eksperti me nje akt noterial ku te shprehe angazhimin me operatorin fitues kundrejt zbatimit te shërbimit te mbikqyrjes per kete object prokurimi (pershkrim per funksionin/rolin qe do te kryeje dhe detyrat perkatese)

***Shenim: Për efekt të vlerësimit me pike sipas pikës 4.4 ne Njoftimin e Kontrates, operatorët të ngarkojnë dokumentacionin: CV, certifikata/diploma/kualifikime profesionale si dhe per Drejtues i Ekipit licencen profesionale për mbikëqyrje.***

Gjithashtu per stafin e propozuar te paraqitet informacioni i kerkuar mbi ekperiencon specifike, sipas percaktimeve te Aneksit nr 1 pjese e ketij DT:

2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të disponojë jo më pak se 14 (katërmbëdhjetë) punonjës të siguar për çdo muaj për periudhën 3 (tre) mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për të vërtetuar këtë kusht, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën për periudhën 3 (tre) mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit, i cili duhet të përputhet me listë pagesat e punonjësve për këtë periudhë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur duke u bazuar ne sherbimet e kerkuara sipas Termave te references,

-Përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e- tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

-Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

*Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,do te paraqiten perpara se AK te jape kontraten.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

**Argumentimi:** *Referuar në nenin 41 pika 4/b te VKM nr. 285, datë 19.05.2021''Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.'' Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me numrin e objekteve të kontrates së zbatimit dhe vendndodhjen e tyre. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës dhe i bazuar në ligj, me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe mbikeqyrjen e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Personeli teknik i inxhinierëve, kapacitetet dhe aftësitë organizative janë të domosdoshëm gjatë mbikeqyrjes së objekteve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për kolaudimin sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe brenda kushteve të kontratës. Në lidhje me inxhinierin e mjedisit operatori/ët ekonomik/ë gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 ''Për mbrojtjen e mjedisit'', ku në nenin 1 parashikohet shprehimisht: ''Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit'' dhe VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo operator ekonomik, person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Roli i inxhinierave eshte percaktuar dhe ne Termat e References.*

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

**A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X**

Sipas rëndësisë:

- |  |                 |
|--|-----------------|
| 1. Çmimi   | <b>pikët 50</b> |
| 2. Eksperienca e ngjashme e kompanisë                | <b>pikët 10</b> |
| 3. Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit | <b>pikët 10</b> |

#### 4. Eksperienca e Stafit Teknik të propozuar

piket 30

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

##### **Kriteret e vlerësimit:**

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

##### **1. Çmimi**

**[0-50] pikë**

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\text{mink1}} \times P_{\text{maxk1}} / O_{k1}$$

$P_{k1}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\text{mink1}}$  Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\text{maxk1}}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k1}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

##### **2. Eksperienca e ngjashme e kompanisë**

**[0 - 10 pikë]**

Ky nenkriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë gjatë zbatimit të shërbimit të kontraktorit, duke qenë se aktivitetet/kontratat e ngjashme të kryera përtej minimumit të kërkuar garantojnë AK që me qëndrueshmërinë në treg, eksperiencën e stafit teknik dhe të vetë organizatës të fituar si dhe kapacitetin e lartë teknik kontraktori mbikqyrës nuk e ve përpara risqeve të mundshme dhe i jep stabilitet zbatimit të kontratës së punimeve

Operatori ekonomik për tu vlerësuar për këtë nën-kriter duhet të paraqesë kontrata me vlerën më të lartë për objekte të ngjashëm përtej minimumit të përcaktuar në kriterin e kualifikimit pika 2.3.1/a, Shtojca 8 dhe që janë realizuar në periudhën kohore brenda tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ofertuesi me vlerën e kontratës së **objektit** të ngjashëm në vlerë absolute më të madhe do ti akordohen pikët maksimale të nën-kriterit dhe ofertuesit e tjerë të kualifikuar (minimalisht sa është përcaktuar në pikën 2.3.1/a), Shtojca 8 ) do ti akordohen pikët sipas metodologjisë/formulës më poshtë:

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\text{maxk5}} \times P_{\text{maxk5}} / O_{k5}$$

$P_{k5}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\text{maxk5}}$  Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e objektit të ngjashëm)

$P_{\text{maxk5}}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k5}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për të plotësuar këtë kërkesë ofertuesit mjaftojnë të sjellin dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kriterit të kualifikimit të parashikuar në Shtojcën 8, pika 2.3.1/a.

### 3. Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit

[0–10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë, në drejtim të detyrimeve që rrjedhin për shërbimin e mbikqyrjes sipas legjislacionit në fuqi, duke mos e vënë Autoritetin Kontraktor në kushte që çënojnë kryerjen me cilësi të kontrates së zbatimit të punimeve

Operatori ekonomik duhet të paraqesë metodologjinë dhe strategjinë e monitorimit të zbatimit të punimeve të mbikqyrjes, mënyrën e raportimit, mënyrën e aprovimit të materialeve të cilat do të vendosen në objekt.

Për të plotësuar këtë kriter ofertuesit duhet të paraqesin një dokument i cili duhet të përfshijë mënyrën e realizimit dhe metodologjinë, si dhe burimet e nevojshme për realizimin e mbikqyrjes sipas metodologjisë përkatëse. Dokumenti duhet të përshkruajë qasjen e supervizionit, risqet e zbatimit të kontrates, indikatorët cilësorë dhe sasiorë për realizimin e qëllimit të punës, rezultatet e pritshme, sigurimin dhe kontrollin e cilësive, monitorimin e kostos, mbrojtjen e mjedisit, sigurimin teknik dhe shëndetit në punë, raportimin, metodologjinë e dorëzimit të objektit në përputhje me legjislacionin dhe standartet në fuqi etj. Vlerësimi do të bëhet bazuar në plotshmërinë e dokumentit të paraqitur.

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij duke iu referuar përcaktimeve në Piken 8/Termat e References

### 4. Eksperienca e Stafit Teknik të propozuar

piket 0-30

Per Lotin nr 1 shperndarja si me poshte:

- |  |          |
|--|----------|
| 1. Drejtues i Ekipit                                   | pike 0-5 |
| 2. Arkitekt  | pike 0-3 |
| 3. Inxhinier Ndërtimi                                  | pike 0-3 |
| 4. Inxhinier Gjeodet                                   | pike 0-3 |
| 5. Inxhinier Elektrik                                  | pike 0-3 |
| 6. Inxhinier Hidroteknik                               | pike 0-3 |
| 7. Inxhinier Mjedis                                    | pike 0-2 |
| 8. Inxhinier Mekanik                                   | pike 0-2 |
| 9. Kontrollor i volumeve të punës (Quantity Surveyour) | pike 0-2 |
| 10. Kontrollor Cilësie                                 | pike 0-2 |
| 11. Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE) | pike 0-2 |

Per Lotin nr 2 shperndarja si me poshte:

- |  |          |
|--|----------|
| 1. Drejtues i Ekipit                                   | pike 0-5 |
| 2. Arkitekt  | pike 0-3 |
| 3. Inxhinier Ndërtimi                                  | pike 0-3 |
| 4. Inxhinier Gjeodet                                   | pike 0-3 |
| 5. Inxhinier Elektrik                                  | pike 0-3 |
| 6. Inxhinier Hidroteknik                               | pike 0-3 |
| 7. Inxhinier Mjedis                                    | pike 0-2 |
| 8. Inxhinier Mekanik                                   | pike 0-2 |
| 9. Kontrollor i volumeve të punës (Quantity Surveyour) | pike 0-2 |
| 10. Kontrollor Cilësie                                 | pike 0-2 |
| 11. Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE) | pike 0-2 |



Per Lotin nr 3 shperndarja si me poshte:

1. Drejtues i Ekipit	pike 0-5
2. Arkitekt	pike 0-3
3. Inxhinier Ndërtimi	pike 0-3
4. Inxhinier Gjeodet	pike 0-3
5. Inxhinier Elektrik	pike 0-3
6. Inxhinier Hidroteknik	pike 0-3
7. Inxhinier Mjedisi	pike 0-2
8. Inxhinier Mekanik	pike 0-2
9. Kontrollor i volumeve te punes (Quantity Surveyour)	pike 0-2
10. Kontrollor Cilesie	pike 0-2
11. Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE)	pike 0-2

Per Lotin nr 4 shperndarja si me poshte:

1. Drejtues i Ekipit	pike 0-5
2. Arkitekt	pike 0-3
3. Inxhinier Ndërtimi	pike 0-3
4. Inxhinier Gjeodet	pike 0-3
5. Inxhinier Elektrik	pike 0-3
6. Inxhinier Hidroteknik	pike 0-3
7. Inxhinier Mjedisi	pike 0-2
8. Inxhinier Mekanik	pike 0-2
9. Kontrollor i volumeve te punes (Quantity Surveyour)	pike 0-2
10. Kontrollor Cilesie	pike 0-2
11. Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE)	pike 0-2

Ky nenkriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë gjatë zbatimit të punimeve të kontraktorit, duke qenë se aktivitetet/eksperiencat e ngjashme ne të cilat ka qenë angazhuar stafi kyc i propozuar nga kompania demostrojne aftesinë teknike dhe profesionale të personave qe do të angazhohen gjatë zbatimit te shërbimit të mbikqyrjes, dhë garantojnë AK që me eksperiencën e fituar të tyre kontraktori nuk e ve përpara risqeve të mundshme dhe i jep stabilitet zbatimit të kontratës se punimeve qe do te mbikqyret.

Operatori ekonomik për tu vlerësuar për këtë nën-kriter duhet të paraqesë eksperiencat e secilit prej stafit kyc te propozuar.

Për të plotësuar këtë kriter ofertuesit do të sjellin dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kriterit të kualifikimit të parashikuar në Shtojcën 8, pika 2.3.3 dhe njekohesisht informacion shtese sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1).

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Për të plotësuar këtë kriter ofertuesit do të sjellin dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kriterit të kualifikimit të parashikuar në Shtojcën 8, pika 2.3.3 dhe njekohesisht informacion shtese sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1).

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Termet e references jane hartuar sipas standardeve dhe ne perputhje me perckatimet ligjore ne fuqi dhe jane pjese e pandare e DST*